

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.(H.) H. nga fshati M., Komuna e P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje e pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzave: PP.II.nr.3797/15 e dt.07.09.2015, PP.II.nr.2600/15 e dt.08.12.2015, PP/II.nr.5137/15 e dt.04.05.2016, PP.II.nr.3588/16 e dt.13.07.2016, PP.II.nr.5841/15 e dt.16.11.2016, PP/II.nr.3589/16 e dt.14.07.2016, PP.II.nr.nr.3135/15 e dt.08.02.2016, PP/II nr.5845/15 e dt.25.01.2016, PP.II.nr.5838/15 e dt.09.02.2016, PP/II.nr.6974/16 e dt.20.02.2017, PP.II.nr.3811/2015 e dt.15.12.2015, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 17.08.2017, në praninë e Prokurorit të Shtetit Hava Krasniqi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. M.H., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 29.08.2017 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**L.H.**, nga babai H. dhe nëna Xh., e gjinisë Rr., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin M.I K. P. ku edhe jeton, me nr. personal të identifikimit *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion – i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra të njëjta penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### S e p s e:

Me dt.16.03.2015, rreth orës 13:00, në vendin e quajtur “R...” në regjionin Ekonomiko –Pyjor të T., Komuna e P., në pyllin në pronësi publike me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri dhe atë 43 copë trungje të llojit bungu, me diametër 14-16 cm, me gjatësi 14metra, me vëllim të përgjithshëm prej 2.69m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Komunës së Podujevës, i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.14.04.2015, rreth orës 15:00, në vendin e quajtur “...” në regjionin Ekonomiko – Pyjor të M., Komuna e P., në pyllin në pronësi publike me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve huaja të luajtshme vetit ti sjell

përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë nga roja e pyllit duke prerë dru zjarri të llojit Ahu, me dimensione të gjata 10-11m, me diametër 18-22cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3,46, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me dt. 13.05. 2015, rreth orës 19:00, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Regjioni Ekonomiko –Pyjor i M., në vendin e quajtur ” ...”, i pandehuri ka prerë 32 copë dru të llojit ahu, me gjatësi 10m, me diametër 25-32cm, me vëllim të përgjithshëm prej 7.80m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me dt.08.06.2015, rreth orës 14:00, në vendin e quajtur “...” regjioni ekonomik-pyjor i M., KK P., me qëllim të vjedhjes në pyll, i pandehuri ka prerë 41 copë trungje të llojit ahu, të gjata 12m, me diametër 18-25cm, me vëllim të përgjithshëm prej 5.80m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.23.06.2015, rreth orës 17:00, në vendin e quajtur “...” regjioni ekonomik-pyjor i Murgullës, Komuna Podujevë, në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna e Podujevës, i pandehuri me qëllim që vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë nga roja e pyllit Xh.Sh., pa leje, duke prerë dru zjarri, lloji “Ahu” në vëllim prej 5.08m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.19.08.2015, rreth orës 15:00, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Sektori i Pylltarisë, në vendin e quajtur “Lisac” Regjioni Ekonomiko Pyjor-Murgull K Podujevë, i pandehuri, ka prerë rreth 22 copë trungje, me sharrë motorike dhe se gjerë në momentin takimit e kishte dëmtuar pyllin në pronësi publike, të llojit Ahu, me dimensione të gjata 14m, me diametër 29-32 cm, e vëllim të përgjithshëm prej 5.60m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sektorit të Pylltarisë i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.24.08.2015, rreth orës 19:00, me qëllim vjedhje në pyllin në pronësi publike të cilin e menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, zyra në Podujevë, në vendin e quajtur “...” Rejoni pyjor i Murgullës, Komuna e Podujevës, i pandehuri me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka prerë 37 copë trungje, dru të llojit ahu, me dimensione 14metra, të gjata, me diametër 29-35cm, me vëllim të përgjithshëm 7.32m<sup>3</sup>, ku edhe është vërejtur nga roja e pyllit me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës, zyra në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 28.08.2015, rreth orës 16:20, në vendin e quajtur “...” në Rajonin Ekonomiko-Pyjor”Murgull” i pandehuri L.H. me qëllim të vjedhjes pa leje paraprake është hasur duke prerë dru, ku në momentin e takimit nga rojtari i pyllit kishte prerë 35 copë trungje të llojit “Ahu” të gjata 14m, me diametër 25-28cm, me vëllim të përgjithshëm prej 7.75m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sektorit të Pylltarisë të Komunës së Podujevës i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.27.05.2016, rreth orës 13:30, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Agjencioni Pyjor i Kosovës KK Podujevë, në vendin e quajtur “...” Regjioni Ekonomiko Pyjor i M., i pandehuri ka prerë 12 copë trungje, me sharrë motorike dhe se gjerë në momentin e takimit e kishte dëmtuar pyllin në pronësi publike të llojit ahu, me dimensione të gjatë 15m, e me diametër 28-40cm, e vëllim të përgjithshëm prej 4,56m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit pyjor të Kosovës KK Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me dt. 31.05.2016, rreth orës 12:30, në pyllin publik të quajtur “...” në regjionin ekonomiko-pyJOR të M., me të cilin menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari-Sektor i Pylltarisë në Podujevë, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme veti t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja i pyllit duke prerë me sharrë motorike dhe bartë me traktor të tipit “IMT 560”, 46 copë trungje të llojit ahu, me dimensione 15 metra të gjata, diametër 20-40cm, me vëllim të përgjithshëm 11.46m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.01.11.2016,rreth orës 14:50, me qëllim të vjedhjes në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, në vendin e quajtur “...” në Regjionin Ekonomiko –PyJOR të M., ka prerë 7 copë trungje të llojit ahu, të gjata 14-17m, me diametër në 35-60cm, dhe me vëllim prej 4.30m<sup>3</sup>, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit PyJOR Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,43,45,73, nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463, të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

**Me dënim me burg** në kohëzgjatje **prej tre (3) muaj**, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **treqind euro (300 €)**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej tridhjetë **(30) ditësh**, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo njëzetë euro (20€), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushalle të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Agjensioni PyJOR i Kosovës zyra në Podujevë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzat: PP.II.nr.3797/15 e dt.07.09.2015, PP.II.nr.2600/15 e dt.08.12.2015, PP/II.nr.5137/15 e dt.04.05.2016, PP.II.nr.3588/16 e dt.13.07.2016, PP.II.nr.5841/15 e dt.16.11.2016, PP/II.nr.3589/16 e dt.14.07.2016, PP.II.nr.nr.3135/15 e dt.08.02.2016, PP/II nr.5845/15 e dt.25.01.2016, PP.II.nr.5838/15 e dt.09.02.2016, PP/II.nr.6974/16 e dt.20.02.2017, PP.II.nr.3811/2015 e dt.15.12.2015, kundër të akuzuarit L. (H.) H. nga fshati M., Komuna e P., për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.03.2017, shqyrtimin e dytë me datë 02.05.2017 dhe shqyrtimin gjyqësor me datë 17.08.2017 në praninë e Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij i autorizuar për shqyrtim gjyqësor, Av.M.H.

Gjykata paraprakisht ka verifikuar të kaluarën kriminale për të akuzuarin e lartcekur dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të akuzuarit L.H. për lëndët: P.nr.894/15, P.nr.1218/15, P.nr.675/16, P.nr.866/16, P.nr.1154/16, P.nr.831/16, P.nr.171/16, P.nr.144/16, P.nr.301/16. P.nr.1243/15 dhe tani e tutje procedura penale për këto lëndë do të mbaj numrin më të vjetër P.nr.894/15.

Pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit në shqyrtimin gjyqësor, i akuzuari L.H. deklaroi, e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzave.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë ka dhen mendimin nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: Se pajtohem me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ngase është bërë konform nenit 248 të KPPRK-së, dhe se pranimi i fajësisë është bërë pasi që është konsultuar me mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuari av. M.H. lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pajtohem me pranimin e fajësisë të klientit tim pasi që këtë e ka bërë me vullnetin e tij dhe pa kurrfarë presioni.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjeve që i përmbajnë aktakuzat në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të pranuar nga akuzuari dhe aktakuzat nuk përmbajnë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të tij si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPP-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par. 4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me fjalën përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetemi pranë aktakuzave dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën përfundimtare deklaroi: Pasi që i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, është i gjendjes së dobët ekonomike iu ka dashur që ndonjëherë të shkoj në pyll për nevoja të veta familjare pasi që deri më tani ka qenë familje me asistencë sociale, me dt. 18.06.2013, ka pasur një aksident të rëndë të komunikacionit dhe prej asaj kohe është me gjendje të rëndë shëndetësore, kërkoi nga gjykata që të lartcekurat ti merr si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit dhe të i caktohet një dënim sa më i butë në suaza të ligjit.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi: E mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsëris veprën penale dhe kërkoi nga gjykata që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, beri rikualifikimin e veprave penale ashtu që i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, pasi që e dëmtuara është e njëjtë, objekti i veprës penale i njëjtë si dhe dashja e kryerësit të veprës penale, të parapara me nenin 81 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, nga se ka qenë i vetëdijshëm për veprimet tij dhe ka dashur kryerjen e veprës penale.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit lidhur me të akuzuarin Liridon Halili, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, ka qenë i gjykuar me edhe më parë për vepra penale të njëjta, sipas aktgjykimeve me numra: P.nr.452/2011, P.nr.396/2015, P.nr.674/2015, P.nr.729/2015, P.nr.1022/15, P.nr.1035/15, P.nr.1055/15, P.nr.1163/15, P.nr.1175/15, P.nr.1242/15 dhe P.nr.300/2016 të gjitha të formës së prerë, si dhe duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është prona publike, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetojë

saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk parqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.894/15,dt.29.08.2017**

**Sekretarja Juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.